


# Fakte mbi Aktivitetin Filantropik 2017

Shqipëria



© Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim  
Tiranë, Shqipëri 2018

Autor:  
Maris Selamaj

Prej vitit 2011 Partnerët Shqipëri punon për promovimin e filantropisë në vend . Duke marrë në konsideratë informacionet e pakta në këtë fushë, **Partnerët Shqipëri** kreu studimet:

- **“Sipërmarrja dhe Filantropia”** për të krijuar një kuptim më të qartë të shkallës dhe natyrës së kauzave shoqërore të cilat mbështeten prej komunitetit të biznesit në Shqipëri,
- **“Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri”**, që trajton këtë veprimtari, figurat kryesore dhe aktivitetin e tyre filantropik brenda dhe jashtë vendit, nga shekulli i XIX e deri në ditët e sotme,
- **“Aktiviteti Filantropik i Ndërmarrjeve në Shqipëri, Studimi i Dytë, 2016”** i cili synon të vlerësojë nivelin dhe karakteristikat e aktivitetit filantropik që kryen sektori i biznesit në Shqipëri, tiparet e zhvillimit të këtij aktiviteti gjatë periudhës 2011-2016, si dhe tendencat për të ardhmen.

Për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e kësaj traditë të hershme dhe me vlera, Partnerët Shqipëri organizon tashmë prej gjashtë vitesh ceremoninë **“Çmimi i Filantropisë”**, duke shprehur mirënjohjen dhe falenderimin për individët, familjet dhe bizneset që kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës në vend. Vlerësimi dhe stimulimi i një aktiviteti të tillë mbetet i rëndësishëm për dimensionin human dhe ekonomik që ai mbart.

Sektori i biznesit luan, midis aktorëve të tjerë, një rol të rëndësishëm në mbështetjen e iniciativave që adresojnë probleme të mprehta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Në këtë funksion, Partnerët Shqipëri ka vendosur një partneritet të ngushtë me sektorin e biznesit në mbështetje të bizneseve të reja sociale në fushën e industrisë së gjelbërt.

Prej vitit 2013 Partnerët Shqipëri organizon konkursin vjetor **“Ide të Gjelbërta”** si pjesë e të cilit mbështeten sipërmarrje që promovojnë përfshirjen sociale, integrimin dhe punësimin, nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve lokale e ringjalljes së traditave, duke ndjekur një përqasje miqësore ndaj mjedisit.

Risia qëndron në bashkëpunimin dhe krijimin e një fondi investimi të përbashkët të krijuar nga dhurime të bizneseve dhe institucioneve filantropike private, lokale dhe ndërkombëtare në mbështetje të bizneseve të reja të gjelbërta. Automatikisht, idetë fituese konkurrojnë në nivel Ballkanik në konkursin **“Filantropia për Ide të Gjelbërta”** organizuar nga Rockefeller Brothers Fund.

Mbledhja e të dhënave mbështetet nga:

## Metodologjia

Ky raport pasqyron aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2016 i sjellë në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe **raportimin e rregullt mujor**.

Metodologjia e përdorur për realizimin e tij u bazua në të dhëna të mbledhura nga hulumtimi ditor i mediave, përfshi ato sociale si dhe nga institucionet publike dhe jo-publike gjatë periudhës janar - dhjetor 2016.

Mbledhja e të dhënave është mbështetur nga **Catalyst Balkans**, një iniciativë që i ka fillimet e saj në fillim të vitit 2013, për të nisur matjen dhe krijimin e mjeteve për promovimin e rritjes dhe përmirësimit të transparencës së filantropisë individuale dhe të biznesit në Ballkanin Perëndimor. Objektivat specifike të organizatës janë grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit, lajmeve dhe të dhënave rreth filantropisë në rajon nëpërmjet databazës GivingBalkans. Zyrat qëndrore të Catalyst janë në Beograd dhe gjithashtu mbulon vendet si: Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia dhe Serbia. Monitorimi ditor është kryer nëpërmjet platformës **klipingmap.com**, një motor kërkimi bazuar në fjalë kyçe.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.

## Fjalor

**OJF** - Organizata Jofitimprurëse

**Publik i Gjerë** - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës


**Ndihmë Ekonomike** - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë me vështirësi ekonomike apo gjatë fatkeqësive natyrore

**Mix** – Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet.

**Dhurime Sezonale** – Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

**TIK** - Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

## Vlera sipas Natyrës në Lekë




Vlera totale e dhurimit të konstatuar në nivel vendi për vitin 2017 është 64,278,086 Lekë, ku përfshihen këto natyra dhurimi: monetare, mallra/produkte, shërbime dhe punë vullnetare.

Edhe këtë vit sikurse në vitin e kaluar, dhurimi monetar zë vendin e parë në natyrën e dhurimeve të kryera me 76,17% të vëllimit total, i ndjekur nga dhurimet miks me 13,14% dhe mallra / produkte me 10,69%.

## Numri i Dhurimeve

347 raste dhurimi janë konstatuar gjatë 2017, nga të cilat 293 (84%) janë kryer në dhurime monetare, 28 (8%) në mallra / produkte, 10 (3%) në shërbime, 10 (3%) miks dhe 6 (2%) në punë vullnetare.






Muaji dhjetor ka qënë muaji me vlerën më të lartë të dhurimit gjatë 2017, me një vlerë prej 16,887,828 Lekë, i ndjekur nga janari me 13,682,073 Lekë dhe 12,531,981 Lekë janë dhuruar gjatë muajit qershor.

Përsa i përketë numrit të rasteve të dhurimit, dhjetori përsëri zë vendin e parë me 123 raste dhurimi, i ndjekur nga qershori me 23 raste, dhe nëntori me 28 raste dhurimi.



## Vlera sipas Dhuruesit në Lekë




Përsa i përket vlerës së dhurimit sektori i Biznesit zë vendin e parë me një vlerë prej 23,027,877 Lekë, të ndjekur nga dhuruesit Miks me 22,584,839 Lekë, dhe Publiku i Gjerë me 8,516,134 Lekë.

Dhurimi me vlerën më të lartë në 2017 është kryer nga dhuruesit miks dhe ka vlerën 8,047,200 Lekë, kjo si rezultat i një fushate ndërkombëtare; Ndërkohë që dhurimi me vlerën më të ulët është regjistruar në shator dhe është kryer nga Individ me një vlerë prej 110 Lekë.


Gjatë 2017 janë regjistruar 89 Biznese që kanë dhuruar 47% të vlerës totale të dhurimeve, dhe 89 Individ, të cilët kanë dhuruar 41% të vlerës totale.

## Numri i Dhuruesve\*



\*Për hater të analizës dhuruesit llogariten vetëm një herë pavarësisht numrit të dhurimeve të kryera gjatë periudhës së monitoruar.

# Fushat e Dhurimit



41.2% (143) e numrit të dhurimeve kanë shkuar për Mbështetjen e Grupeve të Margjinalizuara, ndjekur nga Dhurimet Sezonale me 23.1% (80), dhe Zbutjen e Varfërisë me 11% (38) të vlerës totale.

Tre fushat me vlerën më të lartë për 2017 ishin Shëndetësia me një vlerë prej 24,417,571 Lekë, 14,599,060 Lekë kanë shkuar në fushën e Zbutjes së Varfërisë, dhe 12,209,206 Lekë në Mështetje të Grupeve të Margjinalizuara.




# Përfituesit



Përfituesit kryesor për 2017 kanë qënë Fëmjiët dhe të Rinjtë me 55.07% të totalit të rasteve të dhurimit, ndjekur nga Publiku i Gjerë me 26.96%, dhe Të Rriturit me 6.23%.


Të rritur




Publik i Gjerë




Fëmijë&Të Rinjtë



Kanalet kryesore të dhurimeve janë Institucionet Sociale me 117 raste (49%), 76 (22%) e dhurimeve kanë shkuar direct tek ldividi apo Familja, ndërkohë që 57 (16%) janë kryer perms OJF-ve.



## Shpërndarja Gjeografike e Dhurimeve




Edhe këtë vit qyteti i Tiranës vazhdon të jetë baza e dhuruesve, me 79.8%, ndjekur nga dhurimet në rang Kombëtar me 5.5%. Diaspora është gjithmonë prezente kur bëhet fjalë për mbështetjen e fushatave apo rasteve që kanë nevojë për ndihmë urgjente në Shqipëri.

Për shembull, rasti i Nuredin Sadikaj, një shqiptari që jeton në Milano, Itali. Nuredini ushtronte profesionin e doktorit në spitalin “Et’hem Kapllanaj”, kur jetonte në Shqipëri, tani ai kërë profesion e ushtron në Milano. Me ndihmën e Kryqit të Bardhë Milano, ai arriti të dhurojë një ambulancë me të gjitha pajisjet e nevojshme për spitalin “Et’hem Kapllanaj”.

Një rast tjetër rast ishte shqiptari nga diaspora, i cili dhuroi 20,000 USD për familjen e Z. Tonin Zefit, për rindërtimin e shtëpisë së tyre në Lezhë që po rrënohej.

Edhe në lidhje me përfituesit, qyteti i Tiranës renditet i pari me 75.5% të dhurimeve, i ndjekur nga qyteti i Durrësit dhe Shkodrës me 3.2%.

## Forma e Dhurimit



Numri i dhurimeve për 2017 është rritur me 24% në krahasim me vitin 2016. Monitorimi ka treguar se dhuruesit vazhdojnë të preferojnë dhurimin e drejtpërdrejtë dhe për 2017 numri i dhurimeve të drejtpërdrejta është 233 (67.15%), e ndjekur nga Thirrje për dhurim/Fushata me 82 (23.63%), dhe 32 (9.22%) nëpërmjet Eventeve.

## Evente dhe Fushata gjatë 2017

### Unë besoj në mrekulli

"Unë besoj në mrekulli" ishte koncerti i bamirësisë i organizuar në Teatrin Migjeni që mbledhi bashkë muzikantë të qytetit të Shkodrës. Kjo iniciativë ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për fëmijët me autizëm, shoqëria jo vetëm që duhet të pranojë fëmijët me autizëm, por edhe t'i asistoj ata me ndihmë të vazhdueshme.

Ndërkohë në rrugët e Shkodrës u organizua një marshim sensibilizues për autizmin, një ç'rregullim që vitet e fundit është përhapur gjerësisht në Shqipëri. Të gjitha të ardhurat nga koncerti u përdorën për mbështetjen e fëmijëve me autizëm.

### Food Bank Albania

Gjatë vitit 2017, Food Bank Albania grumbulloi rreth 7 ton ushqim përmes klientëve që kanë blerë gjatë fushatës së tyre të ushqimit në supermarkete në të gjithë vendin. Ushqimi, i cili ishte i barabartë me mbi 20,000 vakte, u shpërnda tek personat në nevojë përmes partneritetit me OJF-të lokale në komunitetet e zgjedhura. Ky projekt i madh, një nga disa projekte që Food Bank Albania po implementon, sjell solidaritet mes komunitetit të supermarketeve, OJF-ve dhe popullsisë së përgjithshme që dhuroi - të gjithë duke luftuar për të njëjtën arsye, zbutjes së varfërisë.

# Të Festojmë Solidaritetin

#CelebratingSolidarity



Gjatë muajve Prill dhe Maj, Partnerët Shqipëri organizoi Festivalin e Solidaritetit. Festivali përfshiu një seri aktivitete të tilla si ngjitje në mal, fushatën "Solidariteti për Ushqim", fushatën për ngritjen e fondeve për fëmijët në nevojë e quajtur "Bëni një Fëmijë të Lumtur", Solidaritet me të Moshuarit, "Diskutojmë mbi Solidaritetin" dhe "Ekspozita mbi Solidaritetin", me qëllim promovimin e shembujve të mirë të solidaritetit nëpër breza.

**Ngjitja në mal** kishte si qëllim solidarizimin me veten, natyrën dhe personat që na rrethojnë.

**Solidariteti për Ushqim** ishte një fushatë e përbashkët me Food Bank Albania, ku në vetëm dy ditë, vullnetarët e rinj arritën të grumbullonin 400 kg ushqime të dhuruara nga qytetarët në disa prej supermarketeve të Tiranës.

Nga ana tjetër, Partnerët Shqipëri ndërmori një fushatë një mujore të quajtur "**Bëj një Fëmijë të Lumtur**", për mbledhjen e dhuratave për fëmijët në nevojë, si një akt për të treguar vëmendjen dhe mbështetjen e shoqërisë ndaj tyre. Lodrat, veshjet dhe librat e mbledhura përmes kësaj nisme iu dhuruan fëmijëve të Fshatit SOS dhe fëmijëve me aftësi ndryshe që frekuentojnë Oendrën Ditore "Oendrojmë së Bashku".


**Solidaritet me të Moshuarit** ishte një aktivitet tjetër, në të cilin bizneset u mobilizuan për të ofruar produkte dhe materiale të nevojshme për Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë. Vullnetarë të rinj, punonjës të kompanive që u përfshinë në aktivitet, vizituan Shtëpinë e të Moshuarve. Ata sollën lule, dhurata dhe u takuan me të moshuarit, duke u sjellë atyre momente gëzimi dhe lumturie.

**"Diskutojmë mbi Solidaritetin"** dhe **"Ekspozita mbi Solidaritetin"**

Ishin dy aktivitete të tjera të arganduara nga Partnerët Shqipëri në kuadër të Festivalit të Solidaritetit.

Diskutimi mbi Solidaritetin konsistoi në një diskutim të madh, ku u përfshinë të rinj, panelistë nga media, përfaqësues të shoqërisë civile, biznesi dhe institucionet shtetërore, të cilët ndanë perspektivat e tyre mbi solidaritetin.

Diskutimi u pasua nga "Ekspozita mbi solidaritetin", bazuar në kontributin e organizatave të shoqërisë civile dhe nisma qytetare në mbështetje të grupeve në nevojë, të prekura nga krizat apo katastrofat natyrore, si dhe fushata të tjera solidariteti



# Media

Si gjithmonë Media vazhdon të jetë mjete kryesor për promovimin e fushatave ndërgjegjëse dhe raportimin e dhurimeve. Facebook dhe emisionet televizive, si Fiks Fare, STOP Show, Club TV etj. vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin e fushatave dhe eventeve për mbledhjen e fondeve, duke promovuar dhe përhapur fjalën në rastet që kanë nevojë për ndihmë, veçanërisht në rastet kur individët ose familjet ndodhen në vështirësi ekonomike, jetojnë në kushte të vështira ose shtëpia e tyre po rrënohet.

Gjatë vitit 2017 janë konstatuar 610 artikuj të publikuar në median sociale dhe të shkruar.


PSH ka konstatuar se dhjetori ka qënë muaji me numrin më të madhë të publikimeve me 85 artikuj, kjo për shkak të festave të fundvitit, një nga periudhat që dhurohet më tepër. Më pas është maj me 36 artikuj, prilli dhe qershori me 31 artikuj.

Mediat të cilat kanë publikuar numrin më të madh të artikujve mbi filantropinë apo rastet e dhurimit kanë qënë: **Shqiptarja.com** (55), **Albeu.com** (44), **Balkanweb** (39), **Oranews.tv** (35) dhe **KohaJone.com** (31).


Shqiptarja.com  
Albeu.com  
Balkanweb.com  
Oranews.tv  
Kohajone.com  
Javanews.al  
Sof.com.al  
Lexo.al  
Gazeta-shqip.com  
Noa.al  
Top-channel.tv  
Gazetatema.net  
Tvklan.al  
Panorama.com.al  
ata.gov.al  
Mapo.al  
Gazetadita.al  
Lajmifundit.al  
Abcnews.al  
Syri.net  
Gazeta Koha Jone  
Newsbomb.al  
Gazeta Dita  
Gazeta Sporti Ekspres  
Opinion.al  
Vizionplus.al  
Shekulli.com.al  
Gazeta Shqiptarja  
Gazeta Panorama  
Periskopi.com  
Opozita.com  
Lajm-shqip.com  
Panorama Sport  
Gazeta Telegraf  
Tirana.al  
360grade.al  
Tiranaobserver.al  
Shqiperia.com  
Gazeta Tema  
24-ore.com  
Rilindjademokratike.com  
Gazeta Mapo  
Gazeta Standard  
RevistaClass.al  
Gazeta Integrimi  
Gazeta Shqiptare

Krahasimi midis vitit  
2016 - 2017

## Vlera Totale e Dhurimit



## Numri Total i Dhurimit



## Fushat e Dhurimit



Edhe pse vlera totale e dhurimit për vitin 2016 është më e lartë se 2017, numri i dhurimeve për vitin 2017 është rritur me 24%.

Për vitin 2017 fushat kryesor të dhurimit kanë qënë Mbështetja e Grupeve të Margjinalizuara (143), ndryshe nga viti 2016 ku numri më i madh i dhurimeve shkoi për Zbutjen e Varfërisë (264).




2017

# Tre Donatorët Kryesorë

2016



■ Biznes ■ Individ ■ OJF




■ Individ ■ Biznes ■ OJF

Për 2016 dhuruesit kryesorë ishin individë (267), ndryshe nga viti 2017 ku numri më i madh i dhurimeve është kryer nga biznesi (89).

Dhjetori ishte muaji me vlerën më të lartë të dhurimeve për 2017, me një vlerë prej 16,887,828 Lekë, ndërkohë për vitin 2016 muaji me dhurimin më të lartë ishte Gushti me 52,107,200 Lekë

## Shperndarja e Dhurimeve mbi Baza Mujore







Partnerët Shqipëri  
Për Ndryshim dhe Zhvillim  
Rruga Sulejman Delvina, N. 18, H.8, Ap. 12, Njësia Bashkiake 5,  
Kodi Postar 1022, Tiranë, Shqipëri,  
Kutia Postare (PO Box) 2418/1  
Tel./Fax 04 2254881  
Email: [partners@partnersalbania.org](mailto:partners@partnersalbania.org)  
<http://www.partnersalbania.org>

Mbështetur Financiarisht nga:



Mbledhja e të dhënave mbështetet nga:

